



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 35/2 prot.

Tiranë, më 21.09.2020

VENDIM

Nr.93, datë 21.09.2020

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 100, DATË 28.10.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA PUSTEC**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 100, datë 28.10.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Pustec, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”*,

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, *“Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”*, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Pustec.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Pustec, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 100, datë 28.10.2019, duke i

lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 3 (tre) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Pustec, me shkresën nr.27 prot., datë 09.01.2020, *“Dërgohet informacioni i kërkuar”*, dhe përmes komunikimit në rrugë elektronike në datat 22 korrik dhe 10 shtator 2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Pustec, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Sipas akteve të administruara në dosjen e verifikimit rezulton se, është konstatuar pavlefshmëria absolute e akteve, duke ndërprerë marrëdhënien e punësimit në kundërshtim me ligjin, për punonjësit: *****, *****, ***** dhe *****.
2. Njësia përgjegjëse ka rishikuar përkrahjet e punës dhe për disa pozicione ka bërë ndryshimet përkatëse në zbatim të detyrave të lëna në vendimin paralajmërues, duke reflektuar ndryshimet e bëra në rregulloren e kësaj bashkie.
3. Njësia përgjegjëse ka realizuar procedurat e konkurrimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.
4. Me Vendimin nr. 02, datë 30.01.2020, Bashkia Pustec ka hartuar dhe miratuar planin vjetor të rekrutimit në shërbimin civil për pozicionet e parashikuara në strukturën e miratuar me Urdhrin nr. 10, datë 20.01.2020, *“Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Pustec për vitin 2020”*.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 100, datë 28.10.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Pustec, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Pustec.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Pustec.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha